

**UNITED
NATIONS**

United Nations
Interim
Administration
Mission
in Kosovo



UNMIK

NATIONS UNIES

Mission
d'Administration
Intérimaire des
Nations Unies au
Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

**KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO**

Ligjislatura e dytë

*Komisioni për Shëndetësi, Punë
dhe Mirëqenie Sociale
Nr. 27/2007*

PROCESVE BAL

i mbledhjes së Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, të mbajtur më 26. 9. 2007, në sallën N-10 , në orën 10.00

Të pranishëm: Fatmire Mulhaxha- Kollçaku, kryetare: Shpresa Murati, Nafije Berisha, Ilaz Pireva, Rudina Bukoshi, Flora Brovina, Fehmi Vula, Zahrije Jusufi, dhe Ferid Agani ,

Morën pjesë

z. Joachim Kehrhahn nga Budenstagu Gjerman

Mbledhjen e drejtoi **Fatmire Mulhaxha – Kollçaku** dhe propozoi këtë:

REND DITE

- 1 Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të datë 18.9.2007 dhe 20.9.2007**
- 2 Shqyrtimi i Projektligji për barnat narkotike ,substancat psikotrope dhe prekursorë.**
- 3 Të ndryshme**

Rendi i ditës u miratua.

U hap shqyrtimi për pikën e parë

1 Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të datë 18.9.2007 dhe 20.9.2007

Nurishahe Hulaj kërkoi që procesverbalit të datës 20.9.2007 t'i shtohet : Për mospagesat e kujdestarive për gjashtëmujorin e parë të viti 2007. Sipas saj se për këtë qëllim janë ndarë 1.20000.00 euro kërkohet të nxerrët akt i veçanët duke shtruar pyetje : A hyjnë në participim të hyrat vetanake në qarkoren e buxhetit apo ne dokumentin kornizë financiar dhe a hyjnë në participim në kodin e pagave e mëditjeve .

Pasi nuk dhënë vërejtje të tjera , të dy procesverbalet u miratuan.

U hap shqyrtimi për pikën e dytë

2. Shqyrtimi i Projektligjit për barnat narkotike ,substancat psikotrope dhe prekursorë.

Fatmire Mulhaxha –Kollçaku, ngriti çështjen e projektligjeve të pa përfunduara dhe u kërkua përshpejtimi i shqyrtimit dhe i procedimit për miratim të projektligjeve. Ajo e ftoi z. Aganin që të raportojë lidhur me Projektligjin për barnat narkotike, substancat psikotrope dhe prekursorë .

Z. Ferid Agani vërejtjet ua ofroi anëtarëve në formë tabelore duke i dhënë komentet të çdo amendamenti. Kontribut dhënë në formulimin e amendamenteve deputetët : Shpresa Murati, Nafije Berisha, Ilaz Pireva, Rudina Bukoshi, Flora Brovina, Fehmi Vula, dhe Zahrije Jusufi,

Komisioni, lidhur me këtë vendosi ta vazhdojë me punën në mbledhjen e radhës , me qëllim të përfundimit të projektligjeve dhe njëherit është kërkuar nga raportuesit t'i përshpejtojnë raportet dhe për këtë nxori :

P ë r f u n d i m

I Komisioni do të mbaj mbledhje më 1.10.2007 dhe më 2.10.2007, ku do të përfundojë me Projektligjin për barnat narkotike, substancat psikotrope dhe prekursorë .

Komisioni do t'i shqyrtojë disa shkresa në mbledhjen e radhës dhe gjithashtu do të marrë qëndrim për procedimin e disa projektligjeve të papërfunduara

Mbledhja përfundoi në orën 12.00

Procesmbajtës,
Rrahim Demaj – zyrtar i lartë ligjor

**Kryetarja e Komisionit
Fatmire Mulhaxha- Kollçaku**